

TASHKO LAKO



E NJOH

FSHATIN UNË

(SKICA DHE SKEÇE HUMORISTIKE)

891.983-7

S

L. 19

TASHKO LAKO

«E NJOH FSHATIN UNË...»

(Skica dhe skeçe humoristike)



20 459

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

ROBI I SHKRESAVE

Hasan Neziri, kryetari i lokalitetit tonë, ka dëgjuar shumë të flitet për burokracinë e sidomos për ata burokratë, të cilët ai i përfytyron të zhytur në shkresa e dosje duke përpiluar koncepte shkresash e duke firmuar e vulosur urdhëra e rregullore. Dhe tek dëgjon, tund kokën, rrudh buzët e flet nëpër dhëmbë: «Tuafër ore, tuafër! Shyqyr i qoftë, punon kau edhe për ata. Paskan rriskun e tyre se, po të jetë për mua, s'i lë t'u kruajë dhëmbi kothere».

Si mendon një copë herë kështu duke e tretur vështrimin në majën e malit përtej, ai kujtohet se e pret puna dhe hyn në zyrë, ulet në krye të tavolinës, çel sirtarët, nxjerr dosjet dhe fillon.

«...Hëm! — murmurit — Ata të Shelkut nuk janë në terezi. Po na prishin nervat. U kam çuar një shkresë dhe përsëri nuk na kanë njoftuar se ç'bëjnë. U do mbledhur këtyre njerëzve. Ndryshe nuk i dilet.

Pa të fillon Hasani e të qëndis një shkresë, domethënë përpilon një urdhër me shkrim, me fjalë «të forta» që, kushdo që ta lexonte, gjaku ujë do t'i bëhej. E merr pastaj Hasani letrën, e fut në zarf, i bie zamkës së zarfit një herë poshtë e lart

me pështymë, e palos, e vulos më të tre cepat dhe ja jep postierit.

— Dëgjon? — i thërret nga pas, posa që ai merr urdhër për në Shelk — T'i thuash edhe me gojë, se ta dhashë unë dhe le t'i zvarrisin më punët po deshën.

Kur postieri zbret poshtë grykave, Hasanit nuk i rrihet më në zyrë. Nuk e mban vendi.

«Po sikur të mos e gjejë kryetarin e kooperativës?! Ku do ta lejë shkresën? Po puna? Do shkoj vetë. Ika!»

Dhe niset Hasani kodër më kodër e qafë më qafë, i bie më shkurt e del në Shelk. Takohet edhe me kryetarin e kooperativës. Bisedojnë.


E sheshojnë problemin, e gjejnë fjalën, caktojnë edhe ditë e data për të përfunduar këtë a atë punë, kur ja arrin postjeri.

— Erdha unë — thotë. — Na një letër o shoku kryetar. Ma dhanë në lokalitet. Ma dha me dorën e tij shoku Hasan.

Hasani ndërhy.

— Merre, merre — i thotë kryetarit të kooperativës. Ja dhashë unë. Sidoqoftë, problemi ka rëndësi. Shkresën e ke. Edhe me gojë e rrafshuam. Tani, veproni, o burra!

Ata ndahen. Kryetari i kooperativës në punë të tij dhe Hasani kodër më kodër, qafë më qafë, arrin përsëri në lokalitet e hyn në zyrë, ulet në krye të tavolinës, çel sirtarët, nxjerr dosjet dhe fillon... Befas i lind një mendim: «Po sikur ata në Shelk edhe pas gjithë këtyre që u thanë e u bënë të mos e vënë ujët në zjarr? Kush do të përgjigjet pastaj?»



I lind edhe ideja:

— T'u dërgoj edhe një shkresë tjetër, më «të forrtë» se e para. Le të mos tunden, në ua mban!

Dhe të nis një letër të gjatë e të gjatë, të shkruan në të e ta mbush me urdhëra e me udhëzime «të rrepta» e «të prera». I vë poshtë një firmë, i këput dhe një vulë e ta thërret postierin. Ai e kundërshton:

— Aty qëparnaj i nisëm një shkresë, o shoku Hasan.

— Një edhe një edhe një, i di unë këto punë. Nisu!

Postieri niset. Hasani, si e sheh që ai humbet pas një gryke, qetësohet.

«Tani e vura ca në vijë» — psherëtin dhe fshin djersët, që i rrjedhin çurk. «U lodhëm, ore, u mbytëm në punë, besoni?!»

Dhe shtrihet Hasani në karrige. Sytë i shkojnë në përsëri andej majave të maleve tek zbardhëllën dëbora e parë dhe mëndja përsëri i vete tek ata burokratët, të cilët, në vend që të jenë operativë në zgjidhjen e problemeve, vijnë e gjëmojnë pas shkresave dhe fletërrufeve.

«Eh! Shyqyr i qoftë. Kanë edhe ata riskun e tyre. Punon kau edhe për ata se, të jetë për mua...»

Dhe tund kokën, duke qeshur nën buzë Hasani ynë sikur të dojë të thotë: «Të jetë për mua, të gjithë në prodhim i çoj. Atje, le të merren me shkresa e shkresurina pastaj.»

KUR FRYHEN «GJELAT».

Kur fryhen gjelat është po ç'është. Sulen të dy, rrahin krahët, skuqin lafshat, mbyllin sytë dhe zënë e ngrehin sqepin lart e turren me sa fuqi kanë e çukisin njëri-tjetrin. E kjo «betejë» vazhdon gjersa të mundet njëri e të largohet me bisht varur. Atëhere, «triumfuesi» bën dy çape tej, i lëshon krahët gjer poshtë e këndon. «Kiki-riki...!» e kjo këngë, e kthyer në gjuhë të njerëzve, do të thotë: Hë! kush është burrë të matet me mua?

Kur ky «dyluftim» ndodh në kopsht, midis gjelit tënd dhe të komshisë, është kënaqësi e madhe për fëmijët që mburren më pas: «Gjel është ai bishtkuqi! Gjak ja bëri lafshën! Po kur e sheh këtë jo midis gjelave të kopshtit, por të themi, bie fjala, midis drejtuesve të kooperativës së shitblerjes si dhe midis këtyre dhe atyre të Bashkimit të kooperativave të shitblerjes, atëhere nuk e pësojnë më «gjelat». Në raste të tilla e pësojnë qytetarët.

Grindja e parë zë fill në kryesinë e vetë kooperativës së shitblerjes, midis kryetarit dhe nënkryetarit të saj. Jep urdhër kryetari. Të bëhet kjo e ajo. E merr vesh nënkryetari dhe e kthen

urdhërin prapë: Këtë sektor e drejtoj unë. Të bëhet kështu e jo ashtu.

I vete fjala në vesh kryetarit:

— Hyqmi im të vejë në vënd. — çirret.

Ndërhyn nënkryetari:

— Jam apo s'jam nënkryetar? Pyetem apo jo? Në rast se pyetem, atëhere kjo punë nuk bëhet.

— Do të bëhet se s'bën, — flet me vendosmëri kryetari. — Kryetar jam unë dhe unë di ç'duhet bërë e ç'nuk duhet bërë.

Po nënkryetari është kryeneç dhe qëndron më të tijën. Kryetari zë e i bën biografinë, duke i kujtuar edhe gabimet e stërgjyshit. Atëhere merr krah nënkryetari e zë e përflet për «yneret» e kryetarit. E kështu njëri i bie gozhdës e tjetri patkoit.

Sherri vete sherr e kandar, që ta ngrerë, nuk ka. E të tjerët u bëjnë sehir «gjelave» të kryesisë e u vënë kapakun:

— E di kryesia.

— E dinë edhe më lart, e dinë. Edhe në Bashkimin e kooperativave e dinë po nuk e ngrënë zërin atje ku duhet.

...Në Bashkimin e kooperativave dëgjon të thuhet:

— Kryetari i kooperativës së shitblerjes së qytetit nuk pyet.

Dhe fillon përsëri «lufta e gjelave» kësaj rradhe midis atyre të Bashkimit të rrethit dhe kooperativës së qytetit, pra midis eprorëve dhe var-tësve. Afërsisht ajo përfshihet në këtë dialog:

— Në Bashkim thonë: Të gjitha furnizimet të kalojnë midis nesh

Kryetari i kooperativës së shitblerjes së qytetit: — As që ju pyes. Kam maqinat e mia. Me to do t'i bie anëmbanë vëndit e do gjej burime furnizimi.

— Të ndalojmë.

— E keni kot.

— Ne jemi eprorë.

— Qofshi me shëndet.

— Repartet e MA-PO-s së re të specializohen.

— Atë e di unë. Ju shihni punën tuaj. Mos na prisni nisiativën.

— More, do të bësh ti si të themi ne apo do të punosh me kokën tënde?

— Me kokën time kam bërë e me atë do të bëj.

Dhe qëndrojnë të dy palët të fryrë e të krekosur e nuk lëshojnë asnjë pëllëmbë vend.

Dhe ti, që shkon këtej a banon këtu, rrudh buzët e tund kryet e vret mendjen të gjesh shkakun e asaj që të shqetëson. Po... qetësohu. Për «gjela» ka edhe gërshërë dhe gërshërët hyjnë në punë kur «gjelave» u rriten pëndët.

ARME TË PATHYESHME DHE PRODHIME TË BOLLSHME!

Gjithë ditën ata shkuan arë më arë dhe, në të varur të diellit, u kthyen aty ku do të kalonin natën.

I zoti i shtëpisë i priti me dorë në zemër, sipas zakonit. Si u sheshuan nëpër shiltet, sikush sipas sërës, e si kuvenduan një copë herë për halle shtëpie e fshati, u shtrua rakia. Fjala sikur u ngroh ca dhe, për lezetllëk, një andej nga mezi i qoshesë së djathtë ja thirri një herë me zë:

*Moj rakia bukuroshe,
Që më shkon qoshe më qoshe!
Rakip xhan, t'u bëfsha ferrë,
Gjeje agronomin një herë!
Pije, more pije,
Se të paska hije!
Shife çfar ka brenda,
Mjalt e moll' të ëmbla.*

Rakip Zequa, kryetari i kooperativës, që kishte zënë vend në krye të qoshesë, sikur u shkund ca.

— Shpejt është për dollinë. Muhabet e zëmër të qëruar nuk gjejmë dot, pa raki ka plot. Dhe e ngau fjalën ashtu siç ngiten qetë e arës — Kështu, që thua ti, or mik xhani, asi kohe, këtyre anëve u bë dyfek i madh. Që më të feksur të yllit të sabahut e gjer më të thyer të ditës u përflak vëndi tej e përtej. U ndez koçimarja që aman, o zot! Ama kur i vumë përpara ishte ç'ishte. Ua mbathte këmbëve gjermani më keq nga italianët. Po... Nejsë thuaj. Hë, gëzuar!

— Gëzuar!

Dhe e bija e hardhisë rridhte zinxhir zinxhir në gurmazet e argasura si opinga lope.

Rakipi krekosej. Domosdo, kur është radha e fjalës, në fshat, nuk e kanë zakon të dalin si bishti përpara sqeparit, kështu që ai, si kryetar kooperative, është plak ndër të gjitha shtëpitë e fshatit; dhe një plak duhet të dijë ç'të tregojë. Ndaj edhe ai di ç'ti tregojë agronomit nga qyteti që, në fund të fundit, në daç për «ndihmë e kontroll» në daç për «kontroll e ndihmë» kishte lënë rehatin e shtëpisë dhe ishte dukur këtyre anëve, thellë në malësi.

— Ja kështu, ja.

Agronomi dëgjonte.

Rakipi nisi sërish.

— E që thua ti, kur i vumë përpara, atje poshtë Qafës së Sykuqit e mbajtën frymën. E pe atë arën atje në gropën e kalit, tek një gorricë e thatë, që ishte si ndonja dymbëdhjetë hektarë?

— Atë që vjet e kishit mbjellë me duhan dhe morët shtatëdhjetë e dy kilogram gjithsejt?

— Hë.

— Ja, atje u plagosa unë dhe xheç e lashë fare lëkurën. Po... Lufta i ka të gjitha

— Ashtu vërtet.

— Aty rashë, po dyfekun nuk e lëshova nga dora. Tak! Një të qëlluar dhe e pashë një festexhi tek e palosa. Pastaj po më linin fuqitë, kur erdhi Sulo Qerimi, ja, ky Sulo që sheh këtu, — dhe tregoi me dorë një fshatar, — më mori, më hodhi krahun dhe, këmbadorazi arritëm gjer atje tek ara ku është çezma e bylykbashit. Vjet atë arë e mbollëm me misër.

— Më thanë se mezi kishit marrë tre kuintalë për hektar.

— Ashtu vërtet. U dogj i flamosuri. Mirë do të ishte të kishim bërë një rrëke e të kishim kthyer vijën e mullirit, po... Mënd për këtej e tutje, thuj. Të shkuara, të harruara. Gëzuar!

Gotat u çukitën, dollia u ndoq gju më gju dhe dikush adej nga mezi i odës i dha një kungatë fjalës:

— Pse nuk i tregon shokut agronom se si e zunë atë ballistin atje te bahçja e qershive mbi mulli?..

— Oho!

— Tregoja, tregoja!..

— Ah ato të bekuara qershi! Desh të mbushte trastën, po la kokën.

Agronomi qeshte me gjithë zemër.

— Prodhojnë qershitë, ë?

— Çka. Po ke parë kështu ti? Sikur po vinë më të shterur. Vjet, po t'i numëroje okë e kokë, mezi i muarëm dhjetë kile për rrënjë.

— Keq — pëshpëriti agronomi.

Dhe kryetari, Rakipi, e shpoi fjalën.

— Kishte hipur qerratai mbi qershi. Kur e shoh! Trak-fap — ja bëj llozit të dyfekut dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë, ai zbriti poshtë e zuri të dridhej si shufër drize.

Përsëri të qeshurat mbushën odën. Agronomi pyeti:

— Po me rrushin si dollët vjet, o kryetar?

— Aha! Na e dogji vrugu të uruarin. Na thau voza e damixhane.

— Pse, nuk e spërkatët, ë?

— More, ę spërkatëm dhe e spërkatëm, po ke parë ti? I ra vrugu dhe e shoi, siç shoi flama pulat.

— Flama?

— Ëhë! Këmbë pule nuk na la vjet. I shoi të gjitha.

— Po pulat e detit?

— Fashistët thuaj. Për to jemi gjallë vetë, ne.

Në odë u gajasën të gjithë. Kryetari, tërë seriozitet, ngriti dollinë.

— Mirëse na erdhe o shoku agronom! Ta paçim borxh për të mirë e në gëzime! Kështu na ardhësh ngaherë, se edhe ne me sebeb të mikut e njomim këtë të shkretë gurmaz. Hajde i gëzuar fare! Armë të pathyeshme dhe prodhime të bollshme!

— Gëzuar!

— Gëzuar!

— Hë më të lumtë goja, se mirë e the.

— O-ho-ho...

Godat u këthyen me fund. Agronomi buzëqeshi.

— Bukur e the, o kryetar, — i tha, — bukur e ngrite dollinë. Veç kësaj që po ngjet tek ju, me sa shoh dhe marr vesh unë, i thonë edhe kështu:

*Dje kundër armikut për trimëri u dallove,
Sot në punë, si dembel, veten turpërove.
Patriot i mirë, more i uruar,
Eshtë ai që punon dhe s'mburret me lavdin' e
shkuar,
Prodhime të bollshme jep puna në arë,
Jo rakia, gostitë, dollitë afsh e zjarr!*

Apo jo, o kryetar?

Rakipi e pa veten ngushtë.

— Ore, i bekuar, — iu drejtua agronomit
— Qenke edhe hokatar!

— E, e, jam ca.

Dhe agronomi, për ta nxjerrë matanë shtegut fjalën e mbarsur, ngriti një dolli të re.

— I gëzuar shoku kryetar! Të gëzuar të gjithë! Sivjet dalshi faqebardhë e u pafsha në krye të tabelës së emulacionit! Marrshi edhe flamurin e garave! Veç për të gjitha këto duhet punë e jo fjalë. Duhet derdhur djersë në arë e jo raki me dolli nëpër gostira, darka e davete. U gëzofshi dhe ngaherë ju këndoftë zemra! Armë të pathyeshme dhe prodhime të bollshme!

Godat u ngritën njëherësh.

Rakipi fshiu buzën me peshqir dhe, si i hodhi një brez rakisë, foli si me gjysmë zëri:

— Kësaj i thonë të qëlluar në shënjë. Qënke snaiper, o shoku agronom. Të paçim faqebardhë!

TE GJITHE QESHEN.

Hallë Qerimenë e njohin «që tek lind e gjer tek perëndon», siç thonë gratë e mëhallës. I ka dalë nami e i ka marrë dhenë. Mos e paçin dikë të sëmurë në shtëpi, pa janë e nga s'janë, plakat i çojnë hallë Qerimesë, për të yshtur nga një filxhan me vaj dhe halla i nomotit me të gjitha të kënduarat e saj. Shërohet ose jo i sëmuri, këtë nuk e di njeri. Këto janë punët e «Zotit», i qcfshim falë. Hallë Qerimeja ka borxh ta yshtë filxhanin tre herë, të thërresë tri herë në yjez, të pështyjë tri herë anës së zjarrit dhe tri herë në rrëzë të trëndafililit dhe kusuri bëhet si është nisur për t'u bërë.

Nami i hallë Qerimesë, qe hapur e kishte marrë dhenë aq sa, kur vinte rasti për të shkuar tek doktori, plakat e mëhallës ta prisnin:

— Ç'është ky doktor, xhanëm! Ku ka si hallë Qerimeja. Ajo ka përpirë vetëtimat e ka mbledhur xhindet një e për një.

Dhe ndodhi njëherë që tezja e Ndrekos na kishte nipin shumë të sëmurë. Djali kishte dy ditë e dy net, që përvëlonte nga të nxehtit e grykët i ishën ënjtur. Kështu e gjeti nusja e Lipes, nga Sheqëza, që vajti për ta parë.

— Ç'bën, moj korbë? — i tha ajo teze Pulijes — Mos e mundo djalin. Dërgo një filxhan vaj tek hallë Qerimeja. Nuk e sheh që djalin ta kanë marrë më sysh? Kështu e pati djalin edhe korba Ngjelinë, po me të shpurë një filxhan vaj tek halla, menjëherë gjeti selamet.

Tezja e Ndrekos as që u mendua, po i tha:

— Të paça me ymër, moj nus'e Lipes, e të arthsha në dasmë të çupave. Unë e mjera u bëra si dru e as që më shkonte në mendje. Mirë thonë zaten, mos na lëntë perëndia pa njerëz.

Duke folur mbushi një filxhan me vaj dhe thirri Ndrekon.

— Na, të keqen tetua, çap te hallë Qerimeja dhe i thua j të na yshtë djalin. Sa për të zënë dorën, jepi këtë vezë e këto pesëdhjetë lekë. Shpejt, dëgjove?

— Dëgjova.

Ndrekuua u bë flutur, ndërsa teze Pulia u fut përsëri në dhomë dhe u ul afër djalit, që dergjej në shtrat.

Ndrekuua po shpejtonte çapat. Në rrugë e sipër, në vitrinën e dyqanit të fshatit, atij i panë sytë portokalle të mira.

«Sa bukur! — tha me vete — Sikur të bleja disa dhe t'ja shpija Petritit? Sa do t'i shijojnë!»

Dhe si hyri brënda në dyqan, bleu të pesëdhjetë lekët portokalle. Pasi luajti ca kohë me shokë, mori rrugën për në shtëpi. Anës së gardhit, këputi një gjethe ferre, e vuri në filxhanin e vajit dhe, kur sosi në shtëpi, pa tezen që po e priste në prak të derës.

— E? — i tha.

Ndrekuua qëndronte rëndë-rëndë.

— E çova — u përgjegj — Halla e nomatisi tri herë. «Merre, më tha, dhe me këtë gjethe ta tymosësh djalin tri herë dhe tri net me radhë do t'ja vësh vajin te koka».

Teze Pulia ja rrëmbeu filxhanin nga dora, u afrua pranë zjarrit, dogji një cep të gjethes së ferrës dhe tymosi me të djalin. Kështu ajo bëri tri ditë me radhë. Ama gjatë këtyre tri ditëve, nga frika e të shoqit, edhe ilaçet e doktorit nuk ja ndau. Sidoqoftë, të tretën ditë, kur erdhi përsëri nusja e Lipes, djali qeshte dhe ishte përkëmbur.

— Të thashë unë — foli serbes ajo. — E pe? Një të nomatisur halla dhe djali u shërua.

— Halla? — Ndrekuva nxori fyellin e nisi t'i bjerë — Ç'hallë moj?

— Halla, o i prapë, halla, hallë Qerimeja. Me ta yshtur ajo, djali u shërua. Mos shkel në gjurmë të saj, o i mallëkuar se tërë jetën e jetës nuk gjen shërim.

— E moj e... — Ndrekuva as që e prishte qejfin — Vajin e teto Pulijes e yshta unë dhe me pesëdhjetë lekët bleva portokalle për Petritin.

— Ç'farë, ç'farë? Ç'thua, more?

— Ja. Atë që të them. Vezën e piva dhe gjethen e ferrës e këputa tek gardhi i Kitos.

— Bobo, ç'ke bërë mor i mallëkuar.

Nusja e Lipes sa nuk vuri kujen dhe bashkë me të edhe teto Pulia, kur ja arriti i shoqi së bashku me infermierin.

— E? — pyeti ai — U shërua, ë? Kështu, hiq dorë nga ato filxhanet që i kishe vënë nën jastëk. Nuk shërohen sëmundjet me magjira. Ato duan ilaçe.

20459

~~51854~~

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER



Teto Pulia tundi kryet me dëshpërim.

— Ashtu të keqen, ashtu. Mirë ma bëri Ndre-
kua.

— Ndrekuja i flamosur thuaj — u hodh e foli
nusja e Lipes, që dridhej. — Mos e marrtë vesh
halla se ec e i u ruaj pastaj. Di shtatë palë të ysh-
tura e të nomatisura ajo.

— E moj, e. Le të nomatisë veten halla, që
po i dalin kryqëzet.

Ndrekuja qeshte. Bashkë me të qeshte edhe
infirmieri, qeshte edhe Petriti i vogël.

NDERI I KUMBARES.

Selim Bajrami qëndronte si me druajtje përpara kryetarit të kooperativës. Ky e ngiste:

— Kështu, ë? I paske dhënë karar, që ta derdhësh fare sonte, ë? Ta tundësh, ë?

— Si urdhëron.

— Hë, më të lumtë!

— Epo... ç'të bëj, o shoku kryetar, më ka lindur që këtu — dhe vuri gishtin tregonjës mbi sisën e mëngjër, — mos ma prish. Ama qethet edhe në djalë në shtëpinë e Selim arixhiut...

— Të kooperativistit Selim Bajrami thuaj — e ndërpreu kryetari, po Selimi vazhdoi në të tijën.

— Mirë, ore, mirë, po unë, ndaç ashtu thuaj e ndaç kështu, prapëseprapë arixhi mbetem. Pa do thuash ti se jemi bërë të gjithë njësh! E di. Të rrojë partia sa mali i Tomorit. Po hë, më bën dot çoban ti mua, fjala vjen? Jo.

— Shko, more shejtan, se po flet çapraz, shko. Për të tjerat shohim e bëjmë.

— E kam nga gëzimi, o shoku kryetar, të keqen. Mos ma prish. Të më vish patjetër. Të më sjellësh edhe Llaqin, kumbaren.

— Si të them.

— Thuaj si të duash, po vetëm të më urdhërosh se kam bërë gati edhe harxhet.

— Aha... Kur është fjala kështu, thuaj qoftë e bërë. Nuk i lëmë të na ikin harxhet kot.

— O më rrofsh e të paça sa malet, o shoku kryetar. Ja, kështu ka lezet. Po... të keqen, mos më harro Llaqin, kumbaren, se pastaj na mbetet djali pa qethur, ore.

— Hajt ti, hajt. Ma lërë mua këtë barrë. Ti veç rregullo ato të tjerat.

— Ashtu, të keqen Selimi, ashtu. Mos u bëj merak hiç fare.

Dhe Selim Bajrami, si bëri një temena me dorë, doli nga zyra e kooperativës, mori rrugën e shtëpisë dhe, kur arriti te lesa, i thirri së shoqes, Qamilesë.

— Dëgjon, moj? Do na vijë vetë kryetari i kooperativës. Të na i bësh gjëllërat ashtu, speciale fare. Shiko mos më turpëro.

— Po agronomi do të vijë?

— Jo. Do të shkojë tek xha Lami për Shënkoll.

— E mirë, de, mirë. Ç'të bëj, thua ti?

— Dëgjo këtu — i tha, si u ul në qoshe e si drodhi një cigare — Na skuq ca zogj për meze, ca djathë, vezë, hudhra e qepë të njoma, pak kos geseje dhe...

— Sa bishta do të nxjerrim?

— Dy. Një për kumbaren e një për krvetarin.

Konaku ishte mbushur plot. Në qoshen e djathtë kishte zënë vënd Llaqi, kumbarja, ndër-sa, në të mëngjërtën, kryetari. Në mes, mbi vatër, mbi një postiqe prej lëkure, ishte ulur i zoti i shtëpisë. Rakia kishte kohë që ishte shtruar. Miqësia sa vinte e bëhej më në qejf. Andej nga cepi, sazexhinjtë ja kishin marrë një të qare me gërnetë.

— Aty, or, aty... Ho, ho, ho... Hajde gëzuar!

Gotat ngriheshin, dollitë qëndiseshin dhe sikush mundohej t'i numëronte fjalët e urimet varg e varg, ashtu zinxhir si rruazat e zinxhirit që formonte ajo e bekuar raki.

— Fjalë burri the.

Gotën e ngriti kryetari.

— Gëzuar, o i zot i shtëpisë, — uroi ai — dhe për gëzime u mbledhshim ngaherë dhe ngaherë gëzim paç në shtëpi. Djali me ymër. U rritë me nënë e me baba, u bëftë i mbarë e arrifshim e i hëngërshim dasmën. Kumbarja pastë dorën e mbarë. Rroftë e qoftë dhe nga këto punë përherë punohtë. Gëzofshim edhe në shtëpi të tij. Hajde, për të mirë fare.

Dhe kryetari e gurgulliti njëherëshe gotën e rakisë. Qejfi u shtua sa aq.

— O më të bëftë mirë, o shoku kryetar.

— Gjak e dhjamë.

— Hidhi, hidhi një brez.

— Njatjeta, njatjeta — kryetari, me njerëzillëk e siç e donte zakoni, i kthente përshëndetjet një e për një.

Me cazë, konaku i Selimit u tund fare nga kënga e vallja. Ishte ngritur kryetari. Vallen ja mbante kumbarja, ndërsa këngën ja hithte Miçua, brigadieri i brigadës së parë. Kryetari këndonte:

*Kumbarja me dor' të mbarë
Peshqeshi me jet' të gjatë.*



— Tunde, or babaxhan, tunde! Ja, kështu ka lezet gostia dhe rakia. Një nga ata të qoshes së mëngjërt, qe bërë fare me qejf dhe hera-herës hidhte edhe nga një fjalë ters.

— Do bëhet qejfi se s'bën, ore. Të rrojë djali dhe kumbarja që na mblodhën.

— Ashtu vërtet, ashtu, — kryetari e përdridhte ca bisedën. — Duhet të jemi sa më afër njëri tjetrit. T'ja shohim hallet njëri-tjetrit.

Gostia vazhdoi gjer vonë. Buka u shtrua aty në të kënduar të gjelave të tretë dhe, kur u përkafte si për përcjellje e u muarr me saze një kaba beratçe, në majë të Tomorit kishte feksur. Fusha qe pështjellë në çarçafin e mjergullës. Një gjiton i Selimit doli në oborr dhe bëri tutje nga cepi, andej nga ishte mbjellë një shtrat kalemesh.

— More, — pëshpëriste me vete — e tundën sonte, e tundën fare.

Në prak të derës, Selimi i përcillte të gjithë me radhë, me dorë në zëmër.

— Të falemi nderit. U mbledhshim kështu nga herë e për gëzime, — e uronin mysafirët dhe Selimi u përgjegjej:

— Nder paçi. Nderi i zotërisë suaj dhe i kumbares.

Kur kapërcyen lesën dhe dolën në rrugë, kryetari e zuri kumbaren prej krahu dhe e pickoi fort.

— Hë, shejtan! Nderi yt, që na paç dorën e mbarë, — dhe u shkul së qeshuri.

— Nderi im, nderi im, pa në të kritikofshin ty që për nderin tim ja shtron me gosti...

— Pse?

— Po qethëm çunin, ore. Pak të duket?

— Ik, more budalla. E ç'u bë? Ne nuk shkuam për davet, po për nder të të zot të shtëpisë, që të mos na thonë pastaj se nuk e sajdisëm nga që është arixhi. Janë të thella këto...

Dhe kryetari shtoi:

— Ktheu në shtëpinë time e merr një sy gjumë. Unë do të shkoj arave. Më duhet të kontrolloj pjesëmarrjen e forcave në punë.

...Kur dielli ishte ngritur tri hostenë, kryetari kthehej nga arat. Një kooperativist, që i shkoi pranë, e përshëndeti:

— Mirë mëngjezi, shoku kryetar. E tundët mbrëmë.

— Ëhë.

Kryetari bëri përpara. Kooperativisti, një buçko djalë, e vështronte nga pas.

«Nuk ja ha qëni shkopin» — pëshpëriste. — «I zoti është, punëtor që shok veten ka, po i ndjek si shumë këto zakonet e vjetra e prapanike».

Kritika po merrte dhenë. Po kryetari? I vinte ende zor të bënte autokritikë. Mbahej në të tijën:

— E de, puna të na vejë mbarë pa s'u bë qameti. Do bërë edhe nderi i të zot të shtëpisë. Duhet të qëndrojmë sa më afër njërëzve, apo jo?

KIRURGU.

Na ishte njëherë dhe na është edhe sot e kësaj dite një doktor kirurg. Të gjithë e thërresin kirurg Asllani e ai, ngrehur e shkrehur, sa herë që shkon rrugës, e mban kokën lart si kalliri pa bukë dhe, kur njerëzia e përshëndetin, e ul pakëz kokën dhe bën përpara.

Kështu kalonin e kalojnë ditët. Kirurg Asllani, tek shihte që njerëzit e nderonin, fryhej e ngrehej sa më shumë.

—E, e — thoshte — kush është si unë? Jam e ç'nuk jam! Shok nuk më gjëndet. Ndaj më duan e më nderojnë të gjithë. More, e ç'janë këta doktorët e tjerë përpara meje? Asgjë!

Dhe filloi kirurgu të vepronte sipas kokës së tij e të mos pyeste njeri.

Një ditë shkoi në poliklinikë. Atje kishin vendosur një tabelë ku shkruhej: «Kirurgu viziton çdo ditë prej orës 17-18» kirurg Asllani veshi bluzën e bardhë dhe vështroi orën. Ajo shënonte 17 e 5 minuta. Doli në prak të derës dhe pyeti: «A ka njeri për te kirurgu?»

Askush nuk u përgjegj.

Kirurgu hyri brenda në dhomë. Kaloi një mi-

nutë, dy, tri dhe askush nuk vinte. «Siç duket, ë paskam shëruar të gjithë — mendoi — Eh! duar të arta kam! Këtu m'u zu fryma. Do të dal jashtë.» Dhe i tha infermieres:

— Unë po largohem. Po erdhi njeri, i thua se më thirrën në urgjencë.

Dhe, si hoqi bluzën e bardhë, xhaxhi kirurgu doli jashtë, filloi të shëtiste e mendja i bridhte poshtë e përpjetë kohëve. Ndërgjegjja nuk e vriste për ndërgjegjen që sajoi.

Në poliklinikë vinin të sëmurë, pyesnin për të, por infermierja përgjigjej: «Ejani nesër. Kirurgun e thirrën në urgjencë.»

Të nesërmen ndodhi përsëri siç ndodhi një ditë më parë. Të pasnesërmen gjithashtu. Kirurgu vinte, vishte bluzën e bardhë, vizitonte ata që ndodheshin aty dhe, posa vështronte që korridori mbetej bosh fluturonte si fluturat krahëlehta drejt e në rrugë ose në kafene.

Atëhere njerëzit filluan të mos durojnë.

— Përse nuk e respekton orarin e punës? — i thanë — Ne kemi nevojë për ndihmën tënde. Ti nuk ke qënë i tillë. Harrove kur të merрте yt atë arave për të prashitur misër? Atëhere ishte goxha çun i mirë! Ç'u bëre kështu, si ndonjë borgjez i vogël!

Kirurg Asllani u tërbua nga inati. Ai nuk ua vinte veshin këshillave të njërzëve dhe filloi të shturej edhe më. Për të, dishiplina shtetërore nuk kishte asnjë kuptim.

— Mbylleni, more, — thoshte — Ju duhet të më falënderoni një mijë herë. Harroni ju, more të pasjellur, që për ju unë ngrihem edhe në mesnatë

FLETE -
RRUFE



për të operuar? Kur do ta zëvendësoj gjumin e humbur? Turp! Unë borgjez i vogël! Turp të kini! Si jua nxë goja atë fjalë?

Atëhere, kur njerëzit e panë që xhaxhi kirurgu nuk donte të përmirësohej, i vunë një fletërrufe në mes të qytetit, ku, midis të tjerash, i thoshnin:

«Ti po humbet cilësitë e mira që kanë karakterizuar gjithmonë popullin tonë. Po fiton mjaft vese të këqia, të huaja për shoqërinë tonë. Po borgjezohesh. Mos harro se je bir fshatari, i rritur midis nesh, me djersën e kësaj toke. Mos e nëm këtë tokë me këto veprime të tua të padenja. Ktheu në jetë.»

Kaqë shkruanin njerëzit. Kirurg Asllani e lexoi fletë rrufenë. Kan kaluar ca dit që atëhere. Unë e pashë edhe një herë, por ai nuk ecte më si kalli pa bukë.

Ja, kaq thotë përralla. Më tej nuk tregon. Siç duket, xhaxhi kirurgu do të ketë biseduar gjërë e gjatë me ndërgjegjen e tij.

NJËZET E PESË PIKAT E ZEÇOS.

Zeço Krekëzën e njeh gjithë fshati. Kur ngri-
tëm kooperativën bujqësore, ai qe ndër të parët që
tha:

— Kooperativën? Ta ngremë dhe fët. Të shihni
se si do të jetojmë këtej e tutje! Bollëk e shkuar
bollëkut.

Dhe në shtëpi, së shoqes, Halimesë, kur i qau
hallin se si do të bënte tani e tutje për të shkuar
në pazar, te miqtë, për gjah, për peshk e ku di
unë, ai ja preu shkurt.

— Rri, moj grua, se s'merr erë ti nga këto
punë. Unë jam agjikator inisiator i ngritjes së koo-
perativës dhe do të më vënë patjetër në krye të
qoshesë. Pastaj të gjithë e dinë se si jam mësuar
unë që në vegjëli dhe nuk do të më shtërngojnë
të hedh valle të re.

Kështu mendonte Zeçua dhe, kur fshati fi-
lloi nga puna e përbashkët, ai, me shkop në dorë,
kthyer takijen mbi sy, shkante sa në një brigadë
në tjetrën dhe buzagaz i shtynte fshatarët, sido-
mos Hankon e Lamçes së Rrodhajve, të punonin sa
më shumë. Pastaj merrte shatën, prashiste dy tre
vija misër ose pambuk — si të ish puna — dhe
si fshinte qafën me peshqir, bënte andej nga go-
rrica, ulej ngadalë, nxirrte kutinë e duhanit, dridh-

te një cigare dhe niste e u tregonte shokëve, që prashisnin aty pranë tij.

— Ç'më kanë parë sytë në gjol! Me të hedhur grepat, kërceu përpjetë një pëndëkuq, ma këputi fillin e grepit dhe u fut përsëri në ujë. Ma punoi si ai lepuri pardje.


— Vërtet?

— Për ç'besoj. E ngrita çiften dhe e prisja të më dilte nga maretë, po ai i mallëkuar m'u hodh në kurriz dhe më shkoi për nën këmbë. Hej djall hej.

Dhe Zequa qeshte një copë herë dhe si mbaronte dy tre cigare duhan, fillonte përsëri nga puna. Në darkë, kur brigadierja maste normat, ai e pyeste:

— E, o brigadiere, sa kam bërë sot?

— Njëzet e pesë pika — i përgjigjej brigadierja dhe Zequa dridhte mustaqet. — Domethënë njëzet



e pesë pikë, ë? Mirë. Të paçim me jetë të gjatë, o brigadier e më dasmë të çupës.

Herë këtu e herë atje, Zequa djersitej dhe në krye të javës, binte e shtrihej në konak sa gjatë gjërë.

— Nuk i thonë shaka — i thoshte së shoqes — Te Selimi darka qe goxha. Gjahu i pardjeshëm më eci mbarë, kurse dje ndënja gjithë ditën në gjol me grepat, po u ktheva bosh. Lëre pastaj sot. Pazar të tillë nuk më kanë parë sytë. Ishin mbledhur nga aneanës. Veç të kishe para e të bleje. Po ajo brigadierja s'më lë të qetë. Bëj ditë për ditë nga njëzet e pesë pikë.

E shoqja zgurdullonte sytë.

— Njëzet e pesë pika? E ç'më thua kështu, o ditëzi? Po unë jam grua dhe bëj një ditë e njëzet pikë. Pse ore, me kaqë e shkon gjithë ditën?

Zequa përdridhte buzët dhe i thoshte:

— E ku merr vesh ti nga pikat.

Kështu, dy ditë te miku, dy ditë për gjah e për peshk, një ditë pushim, një ditë në pazar dhe një ditë pune, ku mezi merrte njëzet e pesë pikë, Zeqo Krekëza e mbylli vitin. Kur u bë mbledhja e përgjithshme, kryetari mbajti një fjalim dhe, midis të tjerash, tha:

— Në kooperativë kush punon nderohet. Për shëmbull, Halimeja e Zeqo Krekëzës ka bërë 320 ditë pune, kurse Zequa ka bërë vetëm 80 ditë pune e as kuqet e as verdhet.

Të gjithë qeshën atë ditë me Zeqo Krekëzën, kurse Hankoja e Lamçe Rredhit iu qas pranë:

— Folë, o Zeqo. E tunde. Le nam në gjithë fshatin.

«E NJOH FSHATIN UNË...»

Treni rrëshqiste me shpejtësi. Herë herë, maqinisti tërhiqte dorezën e sinjalit të sirenës dhe fishkëllima çante ajrin tej e përtej, duke humbur thellë grykave dhe fushave. Në vagonat, udhëtarët, sikush sipas dëshirës, kuvëndonin me njëri-tjetrin, këndonin, lexonin, dremisnin, mendonin. Ishte një udhëtim i zakonshëm në një ditë të zakonshme; ndërsa për një grup të rinjsh, që kishin zënë vënd në një ndarje të njërit prej vagonave të klasit të dytë, ky udhëtim ishte i jashtëzakonshëm.

Ata ishin pesë veta, dy vajza e tre djem, të gjithë në një moshë. Ishin të gjithë fytyrëqeshur e mjaft gazmorë. Kuvëndonin tërë zjarr, qeshnin me gjithë zemër, hidhnin romuze, haheshin në fjalë, herë-herë e ngrinin zërin aq sa thoshje se midis tyre do të pëlciste sherri; pastaj e gjenin fjalën dhe kuvëndimi niste sërishmi më me passion. Ishte një kuvëndim tërheqës. Të rinjtë i hante merakun për punën e përditshme, për jetën, për dëfrimin. Ata flisnin edhe për modën. Thua se këta nuk ishin kooperativistë nga Myzeqeja, po nga ndonjë qytet i madh. Mendimet i shtronin drejt dhe bukur.

Së bashku me ta, në të njëjtën ndarje, udhë-

tonte edhe Sotir Til Semani, myzeqar edhe ky, por ata nuk e njihnin shoqi-shoqin. Ai ishte larguar nga fshati i tij aty e ca vjet më parë dhe tani banonte në qytet, larg Myzeqesë.

Sotiri po u afrohej të gjashtëdhjetave. Ishte burrë i matur në fjalë, i urtë e punëtor i zoti. Gjithë kolektivi e nderonte. Këtë nder ai e kishte fituar me punë.

Veç një të keqe e kishte edhe ky Sotiri. Kur dëgjonte ndonjë, që fliste për fshatin, për ndryshimet në jetën e fshatarëve, qeshte nën buzë, fërkonte qetë qetë mustaqet e holla, rrudhte sytë dhe fliste si me zë të shuar:

— E, e... I di unë këto punë më mirë se kushdo tjetër. Pa ecë në fshat, provoje një jetë të tërë, siç e provova unë, e pastaj urdhëro e fol e ma bëj shesh me lule. A, më thuaj sa për qytetin, po. Të qofsha falë. Këtu ka dalë njeriu nga pocaqillëku dhe rron siç është për të rrojtur. Në fshat djersite, zvarrise në punë aqë sa të këputen kryqëzet dhe, kur vjen fundi, nuk fiton gjë prej gjëje. S'ka si qyteti. Të rrojë partia dhe qeveria, punë më gjetën, fëmijët po i çoj në shkollë dhe po rroj fare mirë. Ç'dua më tepër unë? Shëndet dhe jetë dua.

Kështu mendonte ai edhe tani tek dëgjonte këta të rinj, që e mburrnin aqë shumë jetën e fshatit. Deshi të përzejebë menjëherë në atë kuvend, po mosha e këshilloi të dëgjonte më tepër se sa të flite. Dhe ashtu, me faqe të mbështetur në pëllëmbë të dorës, mbante vesh.

Të rinjtë s'përmbaheshin në fjalë.

— Sido që të bëni ju — fliste njëra prej vajzave, një faqekuqe si mollë starkingë — ne nuk

na arrini. Kooperativa jonë për aktivitet kultural dallohet në gjithë rrethin.

— Po me sportin? — kundërshtonte një djalë shtathedhur si lastar i njomë. — Pa më thuaj pak të lutem, si veni me aktivitetet sportive?

— Do ta rregullojmë edhe atë. Do ta vëmë në rrugë të mbarë.

— Ashtu thuaj.

— E, megjithatë — ngulte këmbë vajza — ju nuk mund të mateni me ne. Ne kemi një shtëpi kulture, kemi vatra kulture në çdo sektor, shkollë 8 vjeçare dhe një rrjetë më të gjërë të veprave social-kulturale dhe të shërbimeve të artizanatit. Infermieren dhe maminë i kemi nga fshati ynë, edhe pjesën më të madhe të mësonjësve po nga fshati ynë i kemi. Ç'do më?

— Ç'dua? Ja, ta them unë ç'dua. A keni ndërtuar ju aqë shtëpi të reja sa janë ndërtuar tek ne? A e keni zbukuruar fshatin tuaj ashtu si ne? A punojnë njerëzit tuaj me aqë këmbëngulje si tek ne? Ja, këto dua. Sa për vepra social-kulturale e rrjet artizanati, as ne nuk kemi mbetur pas.

Vajza belhollë, që rrinte përkrah faqekuqes sonë, nuk e bëri të gjatë.

— Fundi matet me të ardhurat, — ndërhyri — dhe të ardhurat tek ne janë më të mëdha se tek ju.

Sotir Semanit nuk iu durua më gjatë. U ngrit, u mbështet pranë dritares, treti vështrimin fushave dhe pëshpëriti:

— Të rinj, që humbasin mëndjen kot së koti. Na e bënë fshatin dritë me diell. Sikur nuk e njoh fshatin unë!

Po, së fundi, ndërhyri.

— Më shtruar, më shtruar, bij. Mos e merrni me kaq të përpjekur.

Deshi të fliste edhe më gjatë, po njëra prej vajzave iu afroa.

— Po hë, more xhaxha, — i tha me të butë. — E dëgjon si flet? Kërkon të matet me ne.

Sotirit sikur i erdhi mirë që e nisi bisedën me këtë vajzë.

— Epo... — i tha — ka edhe ai arësytet e tij.

— Faktet ç'thonë, — vajza foli pa u përmbajtur. — Nuk ka si fshati ynë.

— Pa më thuaj, nga je ti, moj vajzë? — e pyeti.

— Nga Rrënjëza.

— Nga Rrënjëza? — Sotiri ndjeu një të rrëngethur. Rrënjëza dhe fshati i tij i lindjes formonin një kooperativë bujqësore. — Epo... ç'ka aty në Rrënjëz veç dellit të lumit të vjetër?

Vajza u skuq gjer te majat e veshëve.

— Aa... — i foli me qortim — Mos folë kështu për fshatin tonë, xhaxha. Rrënjëza ka ndryshuar. Nuk është më ajo që ka qënë. Kemi shkollë 8-vjeçare, ambulancë e shtëpi lindje, kopshte e çerdhe fëmijësh, furra e dyqane, grupe teatrale dhe grupe vallëtarësh e këngëtarësh, skuadër futbollit e volejbollit. Tani vumë edhe dritat elektrike e radiot buçasin anëmbanë fshatit. Pak të duken të gjitha këto?

Sotiri tundte kryet.

— Jo nuk më duken pak. Po sa lekë merrni për ditë pune?

Ne në fshat kemi një plak, Gori Semani e

quajnë. Ai ka dy krah pune. Sivjet do të marrë pesëmbëdhjetë mijë lekë të ardhura.

— Kush, Gori Semani?

— Po, Gori Semani. E njeh ti atë? Unë jam mbesa e tij.

— Mbesë nga kush?

— Nga nëna.

— Pse, moj, ti bija e Kalijes je?

Vajza çakëriti sytë kur dëgjoi ti zënë në gojë emrin e s'ëmës.

— Po — i tha. — Po ti nga e njeh nënën time?

Sotiri heshti për një çast dhe vazhdoi.

— E njoh. Kam qënë në fshatin tuaj, po nuk më besohet që Rrënjëza të ketë ndryshuar aq shumë.

Vajza buzëqeshi.

— Ti e bën si një fshatari yni, Sotir Semani e quajnë, që është larguar nga fshati këtu e ca vite të shkuara. Edhe ai, siç kam dëgjuar të thonë, thotë se jeta në fshat është e vështirë dhe se vetëm në qytet jetohet siç duhet.

Sotirit i shkëlqyen sytë.

— Po ti — e pyeti — e njeh atë bashkëfshatarin?

— Nuk e njoh, por, po të ma tregonin e po ta takoja, do t'i thoshnja: Pa eja një herë në fshat, Sotir!

— Hëm! — Sotiri qeshte nën buzë — Kështu, ë?

— Kështu, po. — Vajza ishte bërë flakë e shpuzë.

Sotiri heshti. Shumë herë i kishin folur për fshatin, po ai nuk tundej nga e tija. Edhe tani

zuri e mendohej. Ajo vajza duhej të kishte të drejtë. Fundja, pse vallë e kishte marrë kaq zët fshatin e tij? A thua se kishte vërtet të drejtë? Duhej vajtur në Rrënjëz e pastaj duhej gjykuar. Po, po, kështu duhej bërë.

— Pse mendohe xhaxha?

Ai zë Sotirit iu dëgjua më i ëmbël nga ç'ishte. Buzëqeshi.

— Asgjë, asgjë — i tha — Xheç më sollët në mendje. Sidoqoftë, së shpejti do të takohemi në Rrënjëz dhe atje do ta vazhdojmë bisedën. Atje do të shohim se kush ka të drejtë!

Sirena ushtoi përsëri, po kësaj radhe treni kishte mbërritur në stacion. Sotiri u bë gati të zbriste.

— Udhë e mbarë — i uroi të rinjtë — dhe ti, — iu kthye asaj bukuroshes — mos harro e i jep të fala Kalijes nga unë e, të mirëupafshim në Rrënjëz.

— Nga ti? E cili je ti?

— Sotir Semani.

Dhe Sotiri këceu mbi bankinë. Treni lëvizi përpara. Vajza doli në dritare.

— Xhaxha Sotir? Ju do të ktheheni në fshat?

Sotiri tundi dorën në shenjë përshëndetjeje dhe i thirri:

— Kur të vij në Rrënjëz, do të kuvëndojmë më shtruar.

Lokomotiva e shtoi shpejtësinë.

Tej në stacion, Sotiri kapërxeu bankinën dhe mori rrugën për në qytet.

«Hëm...» murmuriste «Rrënjëza... Sidoqoftë, duhet vajtur.

Dhe humbi në turmën e njerëzve.

SHPËTOMË SOT TI...

Lazja tërhiqte gurmaz-gurmaz rakinë, që bente lulëza në pagur, kafshonte djathë e hudhra të njoma, ndukte cepat e mustaqeve, picërronte sytë dhe vështronte Vasilikën, atë mësuesen nga qyteti, që kishte vajtur aty në fshat së bashku me brigadën kulturele të shkollës.

— Demek — fliste dhe fërkonte mustaqet skrrrop të zeza — do të jepni shfaqje, ë?

— Siurdhëron.

— More, more!.. Ju lumshin këmbët që erdhët e na kujtoni në këtë vlag pune! Po... A s'më thua... çfarë shfaqje do të jepni?

— Estradë.

— Ou! Demek thuaj që do të na thumboni.

— Epo...

— More, more... Po për çfarë do të na kritikon? Moj, se mos na vini në bela me gratë...

Vasilika bëri sikur nuk e kuptoi dhe i ra drejt.

— Epo... Kemi edhe mbeturina të vjetra. Ja, ju nuk i trajtoni gratë siç duhet. Në punët e shtëpisë nuk i ndihmoni fare.

— Hë, hë se kështu janë mësuar tërë jetën këto gratë tona.

— Mirëpo kjo nuk është e drejtë — e ndërpreu

mësuesja. — Ja edhe ju. Pa shihni? Rakinë, meze-
në, të gjitha i doni gati.

— Moj... — Lazja drejtoi trupin. — Pse për
mua e paske zotrote?

— Si ju ka edhe shumë të tjerë.

— Po ç'keni ju, mor jahu, kur gruaja ime nuk
ankohet? — Dhe iu drejtua së shoqes: — Dëgjon, moj
tartakute? Për ty e kanë fjalën. Se mos hap gojë
e më këcen në qafë...



— E pastaj? — e ngacmoi Vasilika.

— E pastaj... pastaj.. — Lazja nuk dinte ç'të thoshte. Ai e drodhi gjuhën, e solli fjalën andej kënde; u shtrua edhe buka, e ai, aty në krye të qoshesë, jepte urdhëra pas urdhërash. Po kur ranë të flinin, nuk u jepte dot udhë mendimeve: «Ke parë kështu ti? Që kanë të drejtë, kanë, po ec e mbushma kokën mua të ziut, të kam rixha. Sot do të kthehem unë në nojma të reja! De o bela, de! Malet fusha po bëhen dhe ne, po përtërihemi si njëherë vahtit, por me gratë gjetëm belanë. U janë hapur sytë të uruarave dhe hajde bëji të gjitha këto që thuhën. Apo ndreqet me rininë. Të kritikojnë në fletërrufe, ashtu fshatçe, ata. E, po, kemi edhe një çikë cipë të shkretën».

— Fli, or, de — i foli e shoqja.

— E ke të lehtë zotrote, po halli im thuaj.

— Hë, hë se do të mësohesh.

— Mbylle moj të thashë!

* * *

Të nesërmen, Lazja, së bashku me gjithë fshatin shkoi në shfaqje. Dikush e shpoi:

— Se mos na cigarisin edhe ne.

— Shpëtomë sot ti, pa herë tjetër shpëtoj vetë — u përgjegj ai.

— Si?

Lazja uli zërin dhe i pëshpëriti shokut në vesh.

— Dëgjomë mua. Kemi gra të bekuara ne. Na e mbajnë nderin tej kufirit por e kemi mbushur shumë zullumin.

— Epo jemi burra, ta marrë dreqi! — shfryu tjetri.

— Edhe ato janë gra.

— Atëhere?

— Në shpëtoftim sot pa na u marrë erzi fshatçe, duhet t'i thërresim mendjes.

... Filloi shfaqja. Mësuesit dhe nxënësit nga qyteti kishin përgatitur një shfaqje estrade me probleme aktuale. Të gjithë qeshnin me lot. Pas çdonumri Lazja pëshpëriste: «Iku edhe kjo... Shpëtova edhe këtë radhë.»

Kur shfaqja mbaroi, ai u kthye në shtëpi.

— Dëgjo — i tha së shoqes, — luaji këmbët e sillmë enën, pasi do të mjel dhëntë.

— Ti?

Ai qeshi.

— Duhet filluar, grua, duhet filluar dhe duhet filluar menjëherë. Turp është të vjedhësh e jo të punosh.

Vonë, pas punëve, ai u shtri në krye të qoshesë dhe i thirri së shoqes.

— Dëgjon, moj! Përse nuk ma ke bërë gati rakinë? Mos do gjë zotrote ta kërkoj me dorë në zëmër?

E shoqja nxori kryet në derë.

— Nise përsëri nga avazi i vjetër, o derëzi?

Lazja qeshi.

— Hë, moj, hë. Ti mos prit nga unë fët e menjëherë të kthej në kllëç të ri. Hë, se harrova, o bela, harrova... dhe u shtri.

Ke parë kështu! Nuk është lehtë të shkëpu-tesh nga e vjetra, jo. Duhet punë, punë dhe vullnet. Duhet dëshira dhe vendosmëria për të flakur tej gunën e vjetër.

LALË MYZEQEJE

Gjyshi im ka lindur mu në zemër të Myzeqesë dhe domosdo edhe pse plakut tim ja ngriti leckat beu dhe era ja përplasi aty mbanë qytetit, unë prapëseprapë «lalë» Myzeqeje mbetem.

Mos u çuditni aspak që i them vetes «lalë». Bile e kam për mburrje. Po jua sqaroj:

Më parë, bejlerët dhe soji e sorollopi i tyre, që qeverisnin vendin, thoshin:

— E ku ka më të poshtër se «lala»? Më thuaj kush bëhet mësonjës? «Lala»! E ku e gjen njeri më të fëlliqur?

— E kuptuat? Ata i thoshin mësuesit njeri «i fëlliqur».

Po nuk e kam fjalën këtu. Puna është gjetkë, tek ai kalë i bekuar, që Nurçe beu na e pat dhënë njëherë me qira dhe që plaku e pagoi «një thelë sa për një pelë».

Kjo rrodhi kështu:

Atë mot plaku mbeti pa punë dhe një mik i tij e këshilloi:

— Bëhu karrocier. Çap e i bjerë beut në gjunjë, se s'dihet, mbase të jep ndonjë kalë me qira...

Deshi s'deshi, plaku shkoi te beu dhe ky «zemërgjerë» i dha vërtet një kalë të ngordhur për

dhjetë franga qira në muaj, po plaku, në vend që të bëhej karrocier, na u bë druvar.

— Po kjo s'ka rëndësi. E keqja është se, megjithëqë plaku punonte tërë ditën duke bërë edhe nga dy rrugë me dru, prapëseprapë, kur vinte muaji, nuk e paguante dot qiranë e kalit.

Kjo punë vazhdoi tre vjet me radhë dhe një ditë, kali i ngriti patkonjtë nga dielli.

Merreni me mend se si u bë plaku im. Lëre pastaj kur dërgoi dhe e thirri beu. Dridhej i tëri. Po beu atë ditë paskesh qëlluar «në të mirat», e priti plakun mirë dhe i tha:

— Dëgjo ti, Kostë. Më thanë se të ka gjetur e keqe e madhe, po mos u dëshpëro. Ka allahu. Kali që goxha hallat, që po ta nxirrje në pazar, i merrte të pesë napolonat. Po unë e kuptoj se ti nuk ke pesë lekë e jo aqë sa bën kali dhe prandaj po ta ul pazarin e po ta lë për tri napolona flori. Mirëpo ti edhe kaq para nuk ke. Atëhere si t'ja bëjmë? Unë e kam mejtuar kështu. Ti puno një vit angari tek unë dhe lahemi me hesapet.

— Po fëmijët ç'të hanë? — që hedhur plaku, por beu kish mbledhur supet.

Deshi, s'deshi, plaku pranoi. Unë u bëra llustraxhi dhe nëna lante rrobat e botës. Kështu, herë ngrënë e herë pa ngrënë, e sosëm atë vit dhe për shën Vasil bëmë hesapet: «Gjatë gjithë vitit kishim dalë hek e hek, veç pesë lekë spec të kuq kishim borxh te usta Xoxi. Kali kish kushtuar treqindgjashtëdhjetë franga qira dhe dyqind e dyzet franga angari që na bëjnë gjashtëqind franga ose tridhjetë napolona flori.

E shihni? Beun e kishim zemërmirë. Nga tre napolona, na i mori kalit tridhjetë napolona.



— Kështu shkuan e vanë motet dhe sot, kur u kthyem së bashku me plakun në apartament, më shtrëngoi fort krahun.

— E sheh? — më tha — Po vjen Nurçe beu. Qëndro. — Dhe kur beu u afrua, plaku i tha.

— Të qenka ulur kurrizi, o Nurçe bej. Urdhëronjë cigare «lale».

Beu na vështroi në sy.

— Kështu, o Kostë? Le djemtë, po edhe ti m'i bëre hasha të gjitha? I harrove të mirat që të kam bërë?

— Bah! Larg qoftë! — i tha plaku. — Ç'llafos kështu zotrote? Harrohen kollaj tridhjetë napolona flori për një kalë?

BEU «DEMOKRAT» QË I BLENTE VOTAT ME DAJAK.

Miq nga anë e anës u mbledhën atë ditë në sarajet e beut të fshatit tonë dhe, për të «nderuar» sa më shumë të zotin e konakut, që i kish «nderuar» duke i thirrur, kush më shumë e kush më pak, sipas takatit, kishin sjellë nga një «copë peshqesh»; Po të veje dorëthatë, beut na i ngelte hatëri e ta mbante vëth në vesh, sa të rronje.

Dasmë nuk ish, sepse beu atë mot nuk kish as djalë dhe as vajzë për të martuar, fejesë nuk na ish, sepse beu na e kish fejuar me kohë çupën dhe as gosti për bukëvale nuk na ish, sepse konaku nuk na ish gëzuar me ndonjë djalë.

Ç'dreq kish beu, atëhere, që na kish thirrur njerëz nga anë e anës e bashkë me ta, si dordoleci që kish vënë babagjyshi në mes të ugarit tonë për të trëmbur serrat, na hidhej e na përdridhej në valle?

— Edhe gjitonët e tij u habitën në fillim me këtë gosti sepse e dinin që beu ynë nuk ish ndonjë dorëlëshuar, po nuk vonoi shumë dhe u sqaruan të gjitha.

Kjo ndodhi kur Pali i Nas Festos doli në fund të shkallëve e u bëri zë hyzmetçinjve.

— Lëvizni, more të mallëkuar. Sot në të gjitha anët e vendit votohet për dovetin dhe beun tonë.

Hyzmetçinjtë nuk i kthyen përgjegje të birit të kryeplakut po u larguan shpejt e shpejt, secili në punë të vet. Atje në një cep, duke u përgatitur për të cuar në divanhane një sërë me zogj të skuqur, Lipi i Kristos (ky kish dy vjet e kusur që punonte si hyzmetçi për të larë faizin e borxhit që kish marrë i ati) i tha Selmanit të Zenunit që, për bukë në gojë, punonte në konak qysh prej tre vjetësh.

— Dëgjove, Selman? Qenkërka ditë e votimeve sot. Prandaj po e derdh beu... t'i marrë votat me lezet.

Ndërkohë, lart në divanhane, i bërë çakërcejf, beu na u ngrit e, me pagurin e rakisë në dorë, zuri të flasë.

— Zotërinj, efendëm, gjithë sa jeni e tek jeni e kam llafin, të na rrojë mbreti pa kusur nuk kemi për të lënë. Hajt, gëzuar!

Paguret u përplasën, gllënjkat u rrukullisën në gurmaz dhe beu, i entuziazmuar (nga rakia domozdo), vazhdoi:

— Ju falemnderit për votat që më sollët. Ju jeni evlatërit e mi dhe po më ngjisni nga të gjitha tabiatet. Hajde, gëzuar!

— Gëzuar e më izmë të zotërisë sate — thirri dikush.

Beu u krekos i tëri si kokoshi mbi pleh.

— More, po unë do ta tund. Me të zënë vend në kolltuk, përnjëherësh për ju do të mejtoj. Veçse — këtu beu qëndroi pak — ju, a i keni votat të gjitha në xhep?

— Siurdhëron. — ja priti kryeplaku.

— Po Rukua?

— Rukua? Edhe ai ka për të ardhur. Nuk e turpëron konakun e zotërisë sate.

— Edhe unë kusur nuk kam për të lënë për kopenë time. Po, po. Kusur nuk kam për të lënë.

Se gjer kur do të vazhdonte ky pehli vanllëk politik, nuk dihej, po beu u ngrit menjëherë në këmbë, kur në derë u dha qahajai.

— E efendëm?

Qahajai uli kokën.

— Ruko kryeplaku sapo erdhi. Fshatarët nuk po i binden dhe nuk ja shitën votat.

— A ua shtoi pazarin?

— Siurdhëron — u përgjegj Rukua duke nxjerrë kokën në derë. — E derdha edhe një qese tjetër po ata qafirë nuk duan të qëndrojnë në izmën të zotërisë sate.

— Dhe ti ma sjell kokën këtu? Marsh në xhandërmari. Shtroji në dru maskarenjtë, delenxhinjtë dhe merru votat. S'ka tërc mërc me mua. Ndaç me të mirë e ndaç me pahir, votat janë të miat. Mos e kurse dajakun, sepse ai ka dalë nga xheneti.

Dhe pa i zbritur inati, beu përfundoi.

— Jezitët. Sa të bëhem deputet pa kusur nuk u kam për të lënë. Kanë për të më njohur se cili jam dhe çfarë kam.

Beu ish bërë shpuzë, po megjithatë, duke çelur pak zërin, iu drejtua miqve të konakut.

— Ja, zotërinj, se ç'të bëjnë hajvanët, që i bien së mirës me shqelm. Megjithatë, unë jam zemërgjerë. Kështu e ka pasur zakon denbabaden oxhaku ynë.



Kaq tha beu dhe kënga nisi përsëri, ndërsa Lipi i Kristos dhe Selmani i Zenunit, që zbritën poshtë në hajat, i treguan xha Rrapos:

— E tundi beu «demokrat». Votat me dajak po i blen. S'ke ç'thua!

* * *

Kjo ka ndodhur këtu e njëzet e pesë vjet të shkuara. Xha Lipi i Kristos dhe Selmani i Zenunit, që u takuan në qendrën e agjitacionit sollën edhe një herë ndër mend atë kohë dhe këtë ngjarje ua treguan të rinjve të fshatit.

AJAZMA E PAPUT.

(Kur priftërinjve e hoxhallarëve po u afrohej fundi).

Papa Ilia ishte ulur në hajatin e kishës dhe numuronte rruazat e tespibes.

«Hë» — fliste sikur të kishte aty pranë priftëreshën, që ja dinte të gjitha huqet. «ke parë kështu ti? Erdhi kohë e keqe, që s'pyet njeri as për shenjt e shënjtore, u paçim uratën» dhe papu bëri tri herë kryq «pa le për prift e psaltës. Shkuan kohërat kur burrit i këndonte binishi».

Papu mori frymë thellë dhe, si i rënë në mendime të mëdha, e ngau më tej:

«Ja, këtu ta kam. Le kryen e qoshesë po edhe fjalën s'ma kthente njeri. Atëhere nga anë e anës vinin. Besonin njerëzia, ndërsa tani, u hyri verzevuli në bark e t'i mëson shenjtanllëqet fëmija që kur ndjehet në bark të së ëmës. Dolën nga udha e zotit e nuk po merret vesh se në çfarë bese janë lidhur. As kungim të bëjnë më, as kurorë, as pagëzim, as...»

— Papu! — thirri një zë gruaje.

— He! — papa Ilia këceu përpjetë. — Kush thirri?

— Unë, papu.

Para tij qëndronte Paçevia e Til Rredhit.

— Oh! Ç'u mundove gjer këtu moj e bekuara e Krishtit?

Papu ja nguli sytë thellë gruas së padjallëzuar që, si bëri tri herë kryq e i puthi dorën me respekt, i foli me gjysmëzëri:

— Të keqen, papu! Në pus më ra një mi i mallëkuar. Ma ndyu pusin që mos qoftë! Merr mundimin e m'i bëj pusit një ajazëm se ngelëm pa larë enët, pa, për të pirë, bëjmë si bëjmë, po i mbushim shtëmbat te pusi i Mitit.

Papa Ilias i shkëlqyen sytë.

— Po folë, moj e bekuar, — i tha. — Ja, tani erdha.

Dhe fluturoi papu në ajodhimë, rrëmbeu petrahilin, kusinë e ajazmës, themjatuan, kryqin, degën e borzilokut dhe u dha në derë të kishës.

— Hajde — i tha Paçevisë, që mënd po këcente nga gëzimi. — Të paska gjetur hata e madhe, po gjene shyqyr që erdhe shpejt e sa pa marrë erë pusi, se pastaj ec dhe e nxirr të paudhin.

Pas një çerek ore, papu hyri në oborrin e Paçevisë së Til Rredhit, qëndroi pranë pusit dhe u bë gati të fillonte nga ajazma, po Paçevia e ndaloi.

— Dale, papu, të paçim uratën. U lodhe shënjtëria jote. Dale të nxjerr një gotë raki.

— Lëre, lëre rakinë e bekuar — ja preu papu dhe shtoi: — ose më mirë ma vërë rakinë në këtë pagur pa e marr me vete dhe e pi sonte në shtëpi. Sillmë pak zjarr për të djegur themjamin.

Dhe papu filloi nga ajazma duke i ardhur rreth e përqark pusit. Sa herë që qëndronte në krye, aty ku ishte Paçevia, këndonte:

«Ajazma e bekuar të ligën e mërgoi
Po ti vërë pranë ndonjë mace si rojë
Që asnjë mi të mos i shpëtojë.

Paçevia, që e kish humbur mendjen e bënte nga tri herë kryq, u përgjegj me gjysmëzëri.

— Ajazmën këndomë ti, papu, pa macen e lidh unë, ja, këtu në grykë të pusit.

— Ashtu folë de, e bekuara e zotit. Ajazmën ta këndoj unë, po hap sytë e gjej ndonjë mace të shëndoshë, se ke parë kështu ti? Edhe minjtë u bënë më të këqinj se shejtani e nuk rrinë uzur.

Kaq tha papu dhe, si mori mundimin — një pesëlekësh — që ja dha Paçevia, futi në xhepin



e brendshëm të rasos pagurin me rakinë e rrushit
zier me gjethe molle dhe u kthye sërish nëpër
rrugën e kishës. Kur mbërriti aty, e priti kishtari.

— E? — e pyeti.

Papu, duke i shkelur synë, iu përgjegj:

— Sa të ketë fyçka si kjo Paçevia e Til Rredhit,
s'do mbetemi edhe ne pa riskun tonë.

DHËNDRIN DOKTOR E DUA!

Personat vepronjës:

1. Thanasi
2. Pulija, e shoqja. 55 vjeç.
3. Majlinda, e bija.
4. Iliri, tornitor

(Një dhomë. Thanasi qëndron ulur. Thërret.)

THANASI : Pulije! Ku je, moj! Dëgjon apo jo?

PULIJA : *(Nxjerr kokën)* Hë.

THANASI . Hë dhe në vend. Pa hajde, pa hajde një herë këtu.

PULIJA : Sa të mbaroj dhe...

THANASI : Lëri të gjitha punët po të them, dëgjon? Me ty e kam.

PULIJA : *(Hyn dhe ulet)* Hë. Veç shpejt.

THANASI : Nuk është punë që merret me grykë kjo. Do marrë shtruar.

PULIJA : Pse?

THANASI : Sepse është fjala për çupën *(pauzë)* Përsëri më erdhi një lajmës. *(bën me shë-*

*një nga spektatorët për të treguar se së
shoqes po i përgatitet një kurth)*

PULIJA : Lajmës? Pa hë!

THANASI : Sot, që thua ti, më zuri Loni. Ti e di atë... I ecën lajmësia.

PULIJA : Nuk të pyes për lajmësin. Për cilin të tha më thuaj, ai më hyn në xhep.

THANASI : Hajde grua, hajde! Lajmësi është gjysma e punës, moj! Kur të vjen lajmësi në derë, do të thotë se pala e çunit i ka dhënë karar se pret fjalën e zotërisë sate.

PULIJA : Po për kë do ta jap fjalën?

THANASI : Ki durim. Që thua ti, ai Loni më tha: «Është djalë i mirë. Ka të bëjë me Maqon, i cili është inxhinier në minierë dhe kushëri me Polikronin, i cili është drejtor në ndërmarjen, në...»

PULIJA : Nuk ke ç'i thua. I mirë qenka, por fundja... Nuk do t'i japim sojin, po djalin. Djali më thuaj kush është e çfarë është.

THANASI : Ke të drejtë. Veç mos harro se duhet edhe rredhi. Nuk kemi dalë nga ferra, të shkretën. Edhe krushqija ka lezetin e saj.

PULIJA : Ti, o burrë, më duket se po e bën si Kozmai i Lip Karroqes atje në fshatin tonë, që kur i erdhi sëra për martesë, i tha lajmësit: «Dua për grua të bijën e papa Leksit». «More po është qorre me një sy», — i kish thënë lajmësi po ai ja kishte mbyllur gojën: «Qorre, qorre, po i thonë e bija e papa Leksit, ama».

THANASI : Epo ky që them unë nuk është qorr,
de.

PULIJA : Po tregoma të shkretën.

THANASI : Është çuni i Kristoforit, Iliri, që punon tornitor.

PULIJA : *(gati sa nuk këcen përpyetë)* Cili, cili the?

THANASI : Tornitori më i mirë i ndërmarrjes ku punon Majlinda.

PULIJA : U pika burrit e pika babaziut, thuaj.

THANASI : Pse moj, ç'pate?

PULIJA : Të flet babai sikur ta kishte çupën të mbeturën e rrugëve. Pika, pika, si ta nxuri goja dhe erdhe ma the edhe mua.

THANASI : E ç'të keqe ka këtu? Djali është goxha i bëshëm. Me zanat...

PULIJA : Të bukur zanat! Kovaçeri hesapi...

THANASI : Tornitor.

PULIJA : Njëllëj është, punë hekurishtesh. Ta kam thënë njëmijë herë, e ja ku po ta them edhe kësaj radhe: O i jap çupës doktor, o s'ka. Çupa ime goxha inxhinierkë na u dashka të marrë një kovaç! Posi!

THANASI : Po ku ta gjej unë doktorin?

PULIJA : E gjen, e gjen po nuk do. Ka plot djem qyteti ynë. Në mos doktor, një inxhinier, një drejtor, një shef. Fundja, kështu e do edhe sëra. I mësuarin me të mësuarin e jo më një zanatçi. Dhe çfarë, me një...

THANASI : Tornitor.

PULIJA : Jo. Nuk e jap çupën atje. Një kam. Nuk më mbytën çupat. Majlinda e mamasë! Në maj lindi dhe si lule maji e ka mamaja. *(Hyn Majlinda së bashku me Ilirin)*

MAJLINDA : (e gëzuar) Mama! Baba! Njihuni me Ilirin. Sot ai prodhoi një vegël, pa të cilën pengohej puna e gjithë ndërmarrjes. Ne jemi shokë.

PULIJA : (Ilirit) Të pastë mamaja. Uluni, uluni!..

THANASI : Pa na tregoni.

ILIRI : Asgjë. Unë prodhova atë që vetë Majlinda e kishte projektuar.

MAJLINDA : Nuk është ashtu. Ti e shprehe i pari idenë. Unë vetëm kalkulimet bëra.

PULIJA : T'u bëftë mamaja. Të ka mamaja me shkollë!

MAJLINDA : E megjithatë, mama, Iliri e bëri detalin, atë veglën desha të them, më të mirë nga ato që sjellim nga jashtë.

PULIJA : T'u bëftë nëna të duarve, more bir! I martuar je?

ILIRI : Jo.

PULIJA : Të hëngërcim dasmën! Lum ajo që do të të marrë me këto duar flori që më ke.

THANASI : Epo... Na nxirr ndonjë gjësendi, de. (Pulija ngrihet, bëhet gati të dalë po Thanasi e arrin) Na! T'i hash dasmën the?

PULIJA : E çfarë të keqe ka këtu?

THANASI : E njëh cili është?

PULIJA : Kur e njëh vajza, edhe unë njohur e kam. Di vajza jonë se çfarë shokësh të zgjedhë. Apo nuk qenka me duar flori.

THANASI : Epo thuaj të trashëgohen.

PULIJA : (befas) Çfarë?

THANASI : Të na trashëgohen po të them. (kthehet nga ata të dy) Ju... Bjerini shkurt e pa ceremonira të shumta.

ILIRI : Unë... Ne të dy njihemi...

THANASI : Kësaj i thoni. (tregon Pulijen) Unë ju
a jap lejen plot pashin.

MAJLINDA : Mama! (i afrohet)

PULIJA : Thanas!

THANASI : Unë e thashë ç'pata për të thënë.

PULIJA : Po unë ç'të them?

THANASI : Të na trashëgohen, thuaj.

PULIJA : Po...

THANASI : Tornitor?

MAJLINDA : Po pse, moj mami? Edhe babai axhus-
tator është, mekanik, punëtor, po ti as
që pyete fare. E more.

PULIJA : Ndryshon puna ime. Unë pa shkollë jam.
Kurse ti, inxhinierkë e mamasë!

MAJLINDA : Mama! Iliri është njeri i vërtetë.
Nuk është doktor, as inxhinier as drej-
tor, as shef, po është punëtor me zemër
të madhe.

THANASI : Hë de! Mos e bëj si Kozmai i Lip
Karroqes, që i tha lajmësit: O të bijën e
papa Leksit, o rashë e vdiqa.

PULIJA : Hë ti, hë! Mbylle, se të gjitha këto
marifetet e tua janë.

THANASI : Ej kokë! Të erdhi dhëndrri në
shtëpi dhe ti nuk lëviz nga vendi.

MAJLINDA : Ne duhemi, mama.

PULIJA : Epo kurr duheni... Hë, mor Thanas,
thuaj...

THANASI : Të trashëgoheni. Të trashëgoheni bijt'e
mi.

PULIJA : Të trashëgoheni! Të trashëgohesh in-
xhinierkë e mamasë.

THANASI : Zure ti?

PULIJA : Nuk thashë gjë, po...

THANASI : Hë, de, hë, se sot të gjithë inxhinierë jemi, drejtorë jemi, shefa jemi, e kupton? Ne jemi në krye, në drejtojmë, po... E di ç'ke ti? Pa na nxirr tani nga fundi i sëndyikut ç'ke ruajtur për dhëndrrin se na u tha gryka. Ejani, ejani bijtë e mi, të shkojmë në dhomën tjetër.

PULIJA : *(duke dalë pas tyre)* Ah ti... Ti i kurdisë të gjitha!

TË MIAT QENË, TONAT MBETEN...

Personat vepronjës

1. Xha Mihali

2. Athinaja, e shoqja.

Lumtëria, sekretare e organizatës bazë të partisë.

(Hyn Xha Mihali dhe i drejtohet së shoqes, teto Athinasë.)

XHA MIHALI : Ku je?

ATHINAJA : Ç'ke që je hardallosur kështu? Kanë kritikuar gjë kryetarin tonë?

XHA MIHALI : Jo.

ATHINAJA : Jo! Po ç'ke kështu? *(alarmohet)* Korba unë, Jorgaqi! Mos na e ka gjetur gjëcunin, o ditëzi.

XHA MIHALI : Jo, jo. Shëndoshë si molla e ke.

ATHINAJA : Plasja se ma nxore xhanin. Folë!

XHA MIHALI : Akoma nuk e ke marrë vesh?

ATHINAJA : Ç'të marr vesh?

XHA MIHALI : Që do na i pakësojnë tredylymshet dhe bagëtitë personale?

- ATHINAJA : Kush do të na i pakësojë?
- XHA MIHALI : Pika mua me kë këmbej fjalë.
Kooperativa, moj, kooperativa do të na
i marrë.
- ATHINAJA : Gjepura. Këto janë llafe xihani.
- XHA MIHALI : Ashtu të duket. Pa lexo gazetën.
Në të tjerat kanë filluar.
- ATHINAJA : Do ta kesh kuptuar kokangulthi.
- XHA MIHALI : U ta ngulsha kokën në mullar të
bykut. Ja moj, dëgjo: do të na pakësojnë
tre dylmshet dhe do të mbajmë nga
një dylm; do të pakësojnë edhe bagëtitë
e do të mbajmë një lopë e dhjetë dhen.
- ATHINAJA : Ashtu, vërtet.
- XHA MIHALI : Po mbylle, se nuk të ka lënë
njeri avukat ty! (pauzë) Hë. Ke gjë për të
thënë zotrote?
- ATHINAJA : Kam. Ku do t'i çojnë këto bagëti
që do të japim si të tepërta?
- XHA MIHALI : Ku do t'i çojnë? (qesh) Hëm! Ku
do t'i çojnë thotë! Në tufët, me shoqet.
Ku do t'i çojnë?
- ATHINAJA : Po lekë?
- XHA MIHALI : Lekët në lëmë.
- ATHINAJA : E pamundur. E ke kuptuar jang-
llësh.
- XHA MIHALI : Plakë, mbylle të thashë, se!..
- ATHINAJA : Kështu si të them unë do të jetë.
Do t'i shkruaj Jorgaqit tonë atje në he-
kurudhë. Ai do të na i shkoqitë punët...
- XHA MIHALI : Të shkoqitsha trutë si koqe misri,
dëgjove? Mbylle e mos e zgjat.
(Hyn Lumja)

LUMJA : Ç'keni që grindeni, xha Mihal?

XHA MIHALI : Ashtu kot, moj bijë. Kur plakët njeriu, në vend që t'i hyjnë, i dalin. Ulu, ulu të paça. Përse u mundove në piskun e vapës?

LUMJA : Jorgaqi kishte çuar lajm nga hekurudha me çunin e Kozmait. «Thuaju atyre pleqve të mi, — i kish thënë, — të mos më turpërojnë. Ti japin të parët bagëtitë e tepërta personale dhe tepricën e oborrit. Se mos kurdisin gjë e më turpërojnë!..

ATHINAJA : U të lumtë goja, mor bir, dhe ty, moj bijë, të lumshin këmbët që erdhe e na solle haberin!

XHA MIHALI : Të bukur haber!

LUMTËRIA : Pse, xha Mihal, ti je kundër? Je kundër interesit të përgjithshëm

XHA MIHALI : A, gjer aty dhe mbaje gojën. Sekretare e organizatës së partisë je vërtet, po këtë fjalë mbaje për vete, se unë nuk e kam turpëruar derën..

LUMTËRIA : Atëhere nuk të pëlqen fjala e tët biri?

XHA MIHALI : Nuk thashë atë.

ATHINAJA : Moj Lumtëri! Si është ajo punë, moj bijë? A na e shkoqit dot?

LUMTËRIA : Po kjo është e qartë, moj teto Athina. Ja, duke dhënë bagëtitë e tepërta dhe tepricën e oborrit, prodhimet ju përsëri do t'i merrni, veç jo në formën e thjeshtë personale, po të gërshetuar me interesin e përgjithshëm.

XHA MIHALI : E zure me fjalë të mëdha, të paça.

Më shkoqur, më shkoqur. A na flet dot më shkoqur?

LUMTËRIA : Si të keni qejf. Ja, do të japësh dy dylm nga oborri yt personal? Po. Të gjitha këto, domethënë oborret, do të punohen nga kooperativa, do të mbillen nga kooperativa, do të vilen nga kooperativa dhe të ardhurat do t'u ndahen anëtarëve me ditë pune.

XHA MIHALI : Prapë nuk e mora vesh. A nuk na e shkoqit më mirë?

LUMTËRIA : Do ta punojmë të gjithë këtë tokë ne? Do ta punojmë. Atëhere do ta vëmë në plan, të themi, ta mbjellim me lule dielli, grurë, perime etj. Do ta marrim lulen e diellit? Do ta marrim edhe do t'ja dorëzojmë shtetit, kurse shteti do të na japë vaj të mirë për aqë lule dielli sa kemi dorëzuar. Këtë vaj do ta ndajmë për ditë pune për secilin anëtar të kooperativës? E kuptuat?

XHA MIHALI : Pa bëj më tej, pa bëj më tej.

ATHINAJA : Pa hë, pa hë.

LUMTËRIA : Kështu edhe me grurin: prodhimin që do të marrim, do ta bëjmë bollgur, trahana, petë, miell dhe të gjitha këto do t'i ndajmë për ditë pune. Edhe me perimet po kështu: do bëjmë turshi, salcë, reçel dhe do t'i ndajmë për ditë pune.

XHA MIHALI : Po me bagëtitë?

LUMTËRIA : Edhe me bagëtitë po kështu. Do të mbliidhen në një tufë të veçantë. Me qumështin do të bëjmë vetë gjizë, djathë,

gjalpë, etj. dhe të gjitha këto do t'i ndajmë për ditë pune.

XHA MIHALI : Domethënë yshyratin do ta marrim prapë ne?

LUMTËRIA : Po, ne e marrim, veçse e marrim të përpunuar.

ATHINAJA : Na e bëjnë hazër, thuaj.

XHA MIHALI : Pusho, moj ti. (*Lumtos*) Domethënë nuk humbasim gjë?

LUMTËRIA : Jo vetëm që nuk humbasim, por edhe fitojmë. Së pari fitojmë rritjen e ndërgjegjes sonë. S'do ta kemi mëndjen vetëm te prona personale, po do të përpiqemi të bëjmë sa më shumë ditë pune në kooperative. Në këtë mënyrë marrim sa më shumë prodhime bujqësore e blegtorale. Kështu interesi i përgjithshëm bashkohet me interesin personal. Kështu rritet edhe mirëqënja jonë personale.

XHA MIHALI : Dëgjo këtu, moj bijë. Kështu po. Do t'i jap bagëtitë e tepërta qysh tani. Të miat qenë, tonat mbeten. Nuk dua të mbetem i fundmi fshatit unë.

ATHINAJA : E thashë unë që e kishe kuptuar kokangulthi ti...

— *Perdja* —

PASQYRA E LENDES

Robi i shkresave	3
Kur fryhen gjelat	7
Armë të pathyeshme dhe prodhime të bollshme	10
Të gjithë qeshën	15
Nderi i kumbares	19
Kirurgu	25
Njëzet e pesë pikat e Zeqos	29
«E njoh fshatin unë»	32
Shpëtomë sot ti... ..	38
Lalë Myzeqeje	42
Beu «demokrat» që i blente votat me dajak	46
Ajazma e paput	51
Dhëndrrin doktor e dua!	55
Të miat qenë, tonat mbetën	61

56314

BIBLIOTEKA E SHETIT
GJROKASTER

Tirazhi 4000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp. NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1971